

## INTERVISTË ME AGON MALIQIN

Prishtinë | Data: 5 korrik, 2017

Kohëzgjatja: 41 minuta

Të pranishëm:

- Agon Maliqi (I intervistuari)
- Aurela Kadriu (Intervistuesja)
- Donjetë Berisha (Kamera)

*Simbolet e komenteve në transkriptë të komunikimi jo-verbal:*

*() - komunikim emocional*

*{ } - i intervistuari shpjegon me gjeste*

*Simbole të tjera në transkriptë:*

*[ ] - shtesë e tekstit për të lehtësuar kuptimin*

*Fusnotat janë shtesa editoriale që japin informacion mbi vendbanime, emra apo shprehje.*

## **Pjesa e Parë**

**Agon Maliqi:** Përshëndetje. Unë jom Agon Maliqi.

**Aurela Kadriu:** Agon, a mundesh me na folë për kujtimet e juja t'hershme t'fëminisë?

**Agon Maliqi:** Kujtimet e hershme t'fëminisë?

**Aurela Kadriu:** Jetën në Prishtinë, qysh ka qenë fëmërija juj n'qat' kohë, n'qat' periudhë? Familjen e juj? Domethonë krejt qito çka e përfshinë... çfarë familje jeni rritë, prapavijat e prindëve edhe krejt jetën qysh u kon' n'mahallë, n'shpi? Krejt çka t'kujtohet.

**Agon Maliqi:** Domethonë, une kom lindë edhe jom rritë në, tash është rruga Nazim Gafurri, atëherë o, atëherë osht' kujt' "Miladin Popović", që është te Shkolla e Mesme Teknike aty domethonë. Sot osht', ajo shtëpi osht' "Klubi M". Kujtimet e hershme! Kujtimet e hershme jonë, s'e di... domethonë oborri i shpisë ka qenë njifarë lloj fushe olimpikë për krejt lagjen, kanë ardhë me lujtë aty. Jom rritë domethonë kryesisht te oborri. Këto jon' kujtimet ma, ma, ma kryesore. Mirëpo edhe te Blloku i Parë, i banesave që osht' përballë. Domethonë, kjo ka qenë ai habitati, mahalla ku, ku jom, jom sillë si fëmi.

Kujtimet e para... nuk e di, domethonë, jon' dy pak a shumë zona t'qytetit që i maj n'men. Domethonë osht' kjo, pjesa e vjetër e qytetit te Blloku i Parë, oborri i shpisë, pak edhe Bregu i Diellit se anej... Gjyshen e kom, kom ndejt shumë edhe te gjyshja andej. Edhe, po edhe pak edhe Ulpiana se kom pasë shokë që kanë qenë në Ulpianë. Kujtimet e para domethonë ma shumë jonë, m'kujtohen do sene që kur ka fillu shkolla njifarë forme. Prej atyhit pak nashta edhe për shkak t'socializimit ma shumë që kemi, rrethi i ri i njerëzve, edhe aty m'kujtohen detajet e para.

Kujtimet e para zakonisht te na jonë, s'po di, lidhen pak a din edhe politike kanihere, se kena qenë fëmi po kena, jena rritë në njifarë tensioni kështu. E kena ni. Edhe pse s'kena kuptu ça po ndodhë, kena qenë ni gjeneratë që e kena ni vazhdimisht njifarë tensioni që po ndodhë rreth neve. T'u e pa njifarë lloj stresi të njerëzve rreth neve, edhe qajo pak kështu m'kujtohet. Ndoshta...

**Aurela Kadriu:** Për cilat vite po flasim t'fëminisë? Ju jeni lindë...

**Agon Maliqi:** Ndoshta edhe për shkak se unë vi prej një familje domethonë që ka qenë politikisht edhe e angazhume, edhe domethonë e informume. Vazhdimisht kanë qenë lajmet e lëshume. Domethonë edhe babi ka qenë i angazhum politikisht edhe udhëtojke nëpër ish-Jugosllavi, jashtë botës nëpër konferenca. Edhe unë, aty e kom fitu ndoshta njifarë nashta vetëdije për atë që po ndodhë, njifarë lloj stresi. Po flas për fundin e '80-tave, fillimin e '90-tave, kur ka qenë taman njifarë lloj... ajo heqja e autonomisë.

Unë kom shku n'klasë t'parë në vitin 1990 kur hala ka qenë sistemi Jugosllav. Edhe e maj men' domethonë që, shkollën fillore "Elena Gjika" e maj n'men që në klasë të parë e kemi pasë atë fotografinë e Titos hala në, në, në shkollë. Mirëpo kemi qenë gjenerata e parë që kanë hy në shkollë që s'kanë qenë Pionierë. Ka pasë qenë njifarë lloj ajo tradite që n'fillim domethonë në klasë të parë kur hishin i vnojshin ato të kuqet {demonstron me duar vendosjen e shallit}, ato të Pionierit. Edhe jemi gjenerata e parë që kur kemi hi në sistem shkollor s'i kemi pasë, s'jemi, s'jemi bo Pionier. Këtë e maj n'men'.

Edhe, mirëpo në klasë të dytë kur kom qenë ka fillu mandej sistemi paralel. E maj n'men' që një kohë, një, një sen' që m'kujtohet ka qenë që për një periudhë të caktume nuk shkojshim mo nëpër shkolla. Diçka, prap po thom njifarë kujtimi, njifarë tensioni, njifarë lloj shqetësimi të prindërve. Edhe e maj n'mend vetën nëpër do shpija në Breg të Diellit kemi majtë klasa me një mësuse aty për një kohë të caktume. Deri sa jemi kthy faktikisht në, në shkollë, në "Elena Gjike", si pjesë e sistemit paralel. Edhe aty mo fotografia e Titos nuk ka qenë.

Qito jonë do kujtime kështu pak ma, ma politike. Po ça m'kujtohet tjetër për shembull meqë jemi edhe n'këtë zonë të qytetit këtu te afër stadiumit... më kujtohen si fëmijë brohoritjet në stadion të Prishtinës. Kur ka lujtë Prishtina, u bojke qyteti krejt qetë, edhe najhere nëse e ngojshim lojën në radio ose dishka, nëse nuk ke qenë në stadion, edhe kur e bojke Prishtina naj gol ashtu u nijke deri te lagjja, deri te lagjja jonë. Ka qenë njifarë qyteti shumë i vogël, shumë ma ndryshe prej atij sot domethonë. Ka lujtë futboll Prishtina në stadion këtu, osht' ndigju gati në krejt qytetin. Ka qenë ma katun, me thonë kështu, se sot.

**Aurela Kadriu:** A mundesh me na tregu pak edhe për prapvijën e familjes, domethonë kompozicionin e familjes, përbamjen?

**Agon Maliqi:** Okej, përbamjen. Kur jom rritë une. Domethonë kur jom rritë unë kemi qenë domethonë me gjyshen, gjyshja ka jetu me neve, me prindët. Jom rritë me gjyshen, gjyshi ka vdekë n'vitet '80-ta, me prindët, mamin edhe babin. Edhe ma vonë, në vitin '94, ma vonë ka lindë edhe motra. Domethonë i kom kalu dhjetë vjet faktikisht une si, si djalë i vetëm. Këta kemi qenë, katër veta nja dhjetë vjet në shtëpi. Mirëpo ka qenë asi familje që, ku krejt, krejt familja domethonë ma e gjanë jonë mbledhë të na. Domethonë çdo natë e kemi pasë aty hallat, axhën. Krejt jemi, domethonë n'mramje jemi mbeldhë te, te shpija jonë. Kështu që jom rritë me djem të hallës, djem të axhës krejt bashkë... qysh thashë në atë stadiumin olimpik aty në, të lagjes në oborr të shpisë. Kjo osht' njifarë forme ajo mjedisi në t'cilin jom rritë.

**Aurela Kadriu:** E përmende që familja ju j ka qenë e angazhume politikisht. Po m'intereson pak ma shumë detaje për qita, prapvijën e prindëve tu edhe qysh kjo ka ndiku mane j n'rritjen e ju j?

**Agon Maliqi:** Po babi jem ka qenë, domethonë, në, i angazhum faktikisht qysh prej kohës... bile pak para se me lindë une, prej '80-tave, me shkrime... Shkëlzen Maliqi domethonë, me analiza, me gazeta. Ma vonë edhe politikisht me Partinë Social Demokrate edhe pjesë e asaj rezistencës civile, e protestave që kanë ndodhë në fund të '80-tave, në fillim të '90-tave. Qysh ka ndiku ajo te une? Tash muj ma shumë me mendu nashta në aspekt retroaktiv, se atëhere nuk osht' që nashta kom pasë naj, naj, naj vetëdije për këto punë. Po, thash domethonë që kom qenë vazhdimisht i vetëdijshëm që ai nuk osht' këtu për shembull, që ka dalë për konferenca, ka dalë nëpër... ja jashtë Kosovës.

Shpesh, për shembull... e maj n'men ka pasë qenë i ngujum në Amerikë nja një vjet [jo], nja një muj se u patën mbyllë kufijtë, s'mujke me u kthy. A din, krejt jon' këto kujtime që si fëmijë i regjistron që diçka s'është n'rregull. Ose kujtime t'tipit – m'duket ka qenë viti '91 '92, a diçka e tillë – më pat' marrë me veti atëherë në Maqedoni. Njifarë konference, nuk e maj n'men edhe çka ka qenë. Edhe në kthim e sipër na pat nalë policia dikun te Ferizaji. Kemi qenë me ni shofer të babit, edhe unë kom qenë aty. Dikun anej te, te kufini dikun anej te Kaçaniku, edhe natë, ora dy e natës. Atëherë ka qenë rrezik shumë. Edhe na patën kontrollu gjithë makinën. Nja, nja dy orë na kanë majtë aty.

Nxerrshin letra "Republika e Kosovës". "Çka o kjo?" Edhe unë e maj n'men njifarë tensioni. Po tensioni jem ka qenë, se unë e kisha një allti [pistoletë] të ujit, që e pata ble në Maqedoni, edhe e pata mshefë nër karrikë (qeshë) se jom tutë mos po ma nxojnë policia. Domethonë qito lloj traumash, qito lloj kujtimesh... se na si fëmi s'kena mujt me i ikë politikës. Edhe qata une ja lo fajin krejt kësaj shtuate pse

na jemi tepër t'politizum si gjeneratë, osht' se politikën e kena pasë n'tona anët. Edhe t'ka nalë policia edhe ti si fëmijë e ki pasë një allti t'ujit, e maj n'men shumë si diçka traumatike që e pata mshefë. Edhe u lutsha "ishalla s'lypin nër karrikë se ma gjejnë alltinë e ujit".

Kështu që angazhimi i tij politik edhe qito domethonë ka, ka mrri deri te ti. Po te unë ka pasë ndikim shumë edhe ta zojmë mjedisi i shpisë. Domethonë librat, gazetatat, diskutimet n'shpi, domethonë që vazhdimisht kanë qenë për këto tema. Kështu që normal qajo manej ndikon te ti se çka, çka t'intereson edhe çka, domethonë nashta ka ndiku besoj shumë edhe n'ata se çka unë jom sot njifarë forme.

**Aurela Kadriu:** Po mandej kur keni shku n'shkollë a ka, a ka pasë naj trajtim ndryshe për juve t'u e pasë parasysh qët' prapavinë politike t'familjes juv? Po flasim për kujtimet e shkollës fillore.

**Agon Maliqi:** Mu personalisht?

**Aurela Kadriu:** Po.

**Agon Maliqi:** Trajtim ndryshe nuk e besoj, nuk kom, nuk kom ndi. Ndoshta, ndoshta jom pak ma...

**Aurela Kadriu:**... sidomos gjatë periudhës kur keni shku nëpër shtëpi-shkolla...

**Agon Maliqi:** Po.

**Aurela Kadriu:** A ka qenë.... Qysh ka qenë narrativa, diskursi n'shpi? A keni, jeni ndi ma i rrezikum gjatë qatye udhëtimeve?

**Agon Maliqi:** Domethonë si shqiptar, domethonë trajtim ndryshe brenda komunitetit shqiptar nuk kom, nuk kemi ni se në atë, ka qenë ni periudhë e homogjenizimit. Domethonë s'ka pasë mo dallime kush vjen prej naj familje kështu komuniste, kush prej çka, domethonë se njifarë forme tensioni ka qenë me sërëbët, me policinë, me kështu. Rreziku osht' ndi. Në të 90-tat në Prishtinë n'përgjithësi nuk je ndi i sigurtë. Domethonë nuk kanë lëvizë njerëzt shumë përtej lagjeve, si fëmijë e mbaj mend domethonë. Sidomos qendra e qytetit ka qenë e rrezikshme. Ka pasë ma shumë banorë serbë nëpër-rreth qendrës, edhe a din si fëmijë kur jon' këto grupet e vogla t'huliganëve t'kanë ndjekë, edhe jemi tutë ka pak.

Po, për me shku n'shkollë, tash ma, specifikisht në Breg të Diellit nuk, nuk m'kujtohet a ka qenë, a ka qenë najfarë rreziku. Mirëpo, tensioni ka qenë prezent se policia ka pasë, ka tregu shumë prezencë

fizike atëhere, domethonë kanë qenë në çdo cep, në tërë qytetin. Bile, e mbaj mend te shpija jeme, aty te, ku osht' pikërisht Shkolla Teknike, te ai trekandëshi që e lidhë, domethonë që shkon për Velani edhe knej për Vranjevc... aty ka qenë, krejt të '90-tave ka qenë një post-bllok. Çdo natë ka qenë policia aty. Ka pasë një, ça i kanë thonë ato, një mjet shumë t'madh policor, edhe aty kështu *randomly*, domethonë rastësisht i kanë, i kanë ndalë njerëzt.

Edhe domethonë ka, m'ka shku gati krejt – ta zojmë prej moshës pesë deri gjashtë vjeçare deri ne '99-tën, une sa herë e kom kalu rrugën e kom pasë policinë prezente aty, edhe... Nuk osht' që ka pasë noj rast, nejtse ka pasë edhe incidente ku jena ndjekë, na kanë ndjekë kjo bandë ose ajo bandë, po për mu ma shumë ka qenë ajo, zhurma e këtij, qysh i thojshin të policisë ato *talky-walky* [radio-lidhje] që i kanë thonë, ato që, që flasin... Përrllëp-përrllëp {onomatope} e kanë pasë njëfarë zhurme. Ajo ka, ajo ka... me bo me ni edhe sot e kom si kështu traumatike se ka qenë taman njëfarë zhurme e përditshme e terrorit njëfarë forme, e tensionit që e ki përjetu sa herë e ki pa, e ki pa policinë.

Edhe atë reagim e kom edhe n'ditë t'sotit ndaj çfarëdo lloj policie e përjetoj ku shkoj n'botë, e kom pak njëfarë kështu ni shtang, ni shtangie se na ka mbet prej asaj kohe. Edhe pse policët në vende tjera të botës jonë përgjithësisht t'sjellshëm, nuk kanë najfar synimi t'keq ndaj teje... mu ma kanë lonë atë traumën edhe atë frikën prej, prej policisë si diçka që duhësh me ju tutë. Kështu që frika ma shumë ka qenë qeshtu. Ma shumë si diçka që e ki ni nëpër ajër se sa diçka konkrete. Ose natyrisht edhe prindët t'kanë, t'kanë paralajmëru a din. Mu n'fakt i maj n'men nja një ose dy raste ku m'ka paralajmëru edhe mami që m'ka thonë, "Kujdes pak ku po shkon, me kon po rrin? Se ti je djali i dikujt që nashta dikush mundet me bo dishka." Këto i mbaj mend, faktikisht nja dy raste. Edhe m'patën lonë përshtypje, a din, se që duhet me pasë kujdes. Kështu që, qato i maj n'men, po.

**Aurela Kadriu:** Mandej, ku keni shku në shkollë t'mesme?

**Agon Maliqi:** Gjimanzi "Sami Frashëri".

**Aurela Kadriu:** Edhe qysh ka qenë qajo periudhë për juve?

**Agon Maliqi:** Une jom gjenerata e fundit faktikisht në, që kemi qenë në "Sami Frashër" nalt në "Kodër të Trimave". N'vitin '98 e kom fillu shkollën e mesme, domethonë kemi qenë hala në sistemin paralel.

**Aurela Kadriu:** Në Kodër të Trimave në shtëpi?

**Agon Maliqi:** Shpija e Herticëve<sup>1</sup>, po. N’sistem paralel. Për mu ka qenë shumë, n’fakt, e randë ajo si përjetim se unë e kom pasë shpinë 30 sekonda ose një minutë prej gjimnazit “Sami Frashëri”. Edhe me deshke me kalu në kamë me pa gjimnazin “Sami Frashëri”... edhe serbët t’u shku në shkollë n’gjimnazin “Sami Frashëri”, t’cilët kanë qenë aq t’pakët në numër që s’e kanë mbushë as shkollën besoj... edhe me kalu aty edhe me marr autobusin – e merrshim ni autobus dikun ose kaniherë e merrshim naj taksi t’vogël, u bojshim grup për me shku, ndonjëherë edhe ecshim, për me ecë deri në “Kodër të Trimave”.

Domethonë, u dufke me kalu njihere aty edhe manej me ecë edhe nja 20 minuta rrugë, gjysë ore rrugë, për me shku në sistemin, sistemin paralel. Domethonë ka qenë ni, domethonë... sot e kujtojna pak edhe me fore atë kohe, domethonë çfarë kushtesh kanë qenë ato shpija me.... Domethonë ni shpi që i futshin mrena 200 e disa nxansa. U dufke m’i deshë këpucat në hymje. Ka qenë dhoma e këpucave që ka pasë njëfarë ere t’ranë (qeshë). Edhe s’po di. Domethonë qajo osht’ përjetimi i shkollës t’mesme. Mandej e kemi ndërpre aty, afër fundit vitit parë ka fillu lufta edhe.... Po kom shumë kujtime prej asaj periudhe se edhe ma i rritun, 14 vjeçar, ata e maj n’mend kështu shumë, shumë kthjellët.

**Aurela Kadriu:** E periudhën e luftës a e keni kalu në Prishtinë apo... qysh ka qenë për juve periudha mbasi që u nda shkolla, që u kry edhe filloj lufta?

**Agon Maliqi:** Nuk e maj n’men saktë momentin kur osht’ ndërpre. E di që une, unë jom largu me 23 mars, ni ditë para bombardimeve, në Maqedoni. Nuk kom, nuk kom qenë këtej gjatë bombardimeve. Kemi, jemi largu për shkak se babin e kom pasë në Zvicërr jashtë, edhe ai, ai nga frika që po fillon diçka na tërheqi, na tërhoqi edhe neve meqë ai s’mujke me u kthy. Kom qenë në Maqedoni gjatë luftës edhe.... Po tensionin e maj n’men domethonë, se n’fakt ajo shpija e Herticëve osht’ ni pozicion shumë strategjik edhe prej aty nalt shihet ni pjesë e bukur e mirë e Llapit.

Edhe kur kish luftime, ta zojmë, në Llap aty u nijke edhe n’shkollë. Kohna shumë abnormale kanë qenë. Po me 23 mars kom, kom shku edhe manej jom kthy, nëse s’gabo, me 4 korrik. Ka qenë *4th of July*<sup>2</sup> pikërisht kur jom kthy në Prishtinë, në ‘99-tën.

**Aurela Kadriu:** Qysh, po mendoj për periudhën në Maqedoni, a keni nejtë si refugjatë, a keni...

**Agon Maliqi:** Po, po po. Kemi qenë refugjatë. E maj n’men ato, kemi pasë ato kartonat e gjelbërt *zgrizeno lice* u qujshin. *Begalci* [refugjatë] na thojshin. Kemi qenë të zhvendosun në Tetovë, ni familje

<sup>1</sup> Familja Hertica gjatë sistemit paralel në vitet e ‘90-ta kishin lëshuar shtëpinë e tyre në lagjen Kodra e Trimave për gjimnazin “Sami Frashëri”.

<sup>2</sup> Ang.: *4th of July*, 4 korrik, Dita e Pavarsisë së Amerikës.

që na kanë pritë atëherë. Edhe për ni kohë kemi shku edhe në shkollë, në gjimnazin e Tetovës. E patëm bo njifarë improvizimi, majshim klasa sa mos me hupë, sa mos me...

**Aurela Kadriu:** A ju kanë numëru ato, ajo periudhë e shkollës manej kur jeni kthy...

**Agon Maliqi:** Jo, nuk m'doket që na u kanë numëru. Ato kanë qenë e vështirë me administru n'kthim masnej prej ktuhit kush ku ka shku, a din. Kemi qenë t'shprëndamë krejt refugjatë do në Shqipëri, do...

**Aurela Kadriu:** Çka ka ndodhë me shkollën kur jeni kthy?

**Agon Maliqi:** Kur jemi kthy, nëse nuk gaboj, na jemi kthy domethonë verës, kemi fillu në shtator mandej mandej në "Sami Frashër". Edhe diçka e kemi pasë mbajtë njifarë periudhe, si dy javë, kishe si me kompenzu atë vitin paraprak. Diçka qashtu m'doket ka qenë a din, pak si formalisht na e kanë kry atë vitin e parë. Kemi bo diçka, nëse s'gaboj, nja ni periudhë t'caktume që me përfundu vitin që e patëm lonë n'gjysë edhe mandej patëm vazhdu normalisht vitin e ardhshëm. Po normal, tash kësaj here në ndërtesën e "Sami Frashërit".

**Aurela Kadriu:** Edhe a mban mend najsen prej qasaj periudhës kur jeni kthy në shkollë? A e mban mend mbramjen e maturës, ose diçka të tillë? Domethonë, ambientin?

**Agon Maliqi:** Po...

**Aurela Kadriu:** Atmosferën?

**Agon Maliqi:** Atmosfera, s'po di. E maj n'men jashtëzakonisht mirë ditën e parë kur kemi hy në gjimnazin "Sami Frashëri". Për neve ka qenë përjetim shumë... domethonë se shumë hapsina t'qytetit kanë qenë të ndalume për neve, tash përnihere m'i pa për herë t'parë. Unë e maj n'men shumë mirë kur kom hi n'gjimnaz i mahnitun me sallën... domethonë me krahasu me shpinë e Herticëve ka pasë qenë domethonë si naj pallat mbretënor na u dok'ke. E maj n'men kur kom hy në, në, në "Boro Ramiz" për shembull në sallën e sporteve që ka qenë... ke kalu aty gjithë jetën edhe s'ke, s'të ka çu kurrë rruga me hy n'sallë t'sporteve. Domethonë në moshë tash 15 vjeçare për herë t'parë me hy në, në sallë t'sporteve ka pasë qenë ni përjetim i jashtëzakonshëm.

Domethonë papritmas ni dimension krejt i ri i qytetit, t'cilit na s'kena pasë qasje ma herët. Ça maj n'men në "Sami Frashër" tjetër? Maj n'men, detaje t'adoleshencës mo, a din. E maj n'men vijshin projekte të ndryshme me na ndihmu, donacione. Kosova ka qenë atëherë vatër e ktyre sendeve. Na



patën instalu njifarë sistemi të, audio-sistemi, n'çdo klasë ka pasë kështu *sound-system*, autoparlanta edhe ni sistem qendror në bodrum ku ka qenë njifarë lloj si miksete, si DJ. E patëm bo edhe DJ-në e... edhe unë bile, m'pat ra me lëshu muzikë disa herë... DJ i shkollës. Në mes të orëve, bike zilja, u lëshojke naj kangë. Ose në pushim t'gjatë. Njoftimet u bojshin... e qesi sene.

Domethonë do qesi detaje m'kujtohen, a din, kishe filloi njifarë si, njifarë periudhe krejt e re për neve. Sene që s'na ka shku menja që mujn me ndodhë.

**Aurela Kadriu:** Mandej qysh... a po na tregon tashti ma n'detaje t'lutna për qita, qysh ka ndodhë, qysh ke ni për "Postpesimistët" edhe qysh ka ndodhë inkuadrimi juj në "Postpesimistët"?

**Agon Maliqi:** Për "Postpesimistët" unë kom ni edhe para luftës. Domethonë kom qenë në atë moshën 13-14 vjet edhe diqysh ka ardhë informacioni të unë. Nashta përmes prindëve, nashta... ashtu e kom dijtë që osht' organizatë e t'rive që prodhojnë domethonë jo gazetën, jo gjana t'tilla, mirëpo nuk osht' që kom pasë naj, naj, naj kontakt të drejtëpërdrejtë. Ma n'detaj kom pasë, domethonë ma shumë kom ni domethonë mas luftës njifarë forme kur disa shokë t'mi inkuadrohen edhe përfshihen aty. Edhe, domethonë mandej nuk m'kujtohen si-qysh rrethanat, m'ftojnë edhe mu me shku me ni takim të "Postpesimistëve".

Edhe prej aty tutje manej fillova me shku rregullisht edhe domethonë u bona si anëtar. Kështu e kujtoj pak si mjegullt, n'kontekstin se qysh, po e di që për herë t'parë kom qenë në, te Salla e Kuqe e Pallatit të Rinisë. Aty nalt te kati i dytë i Sallës Kuqe kanë qenë do dhoma, do si zyre. Aty e kemi pasë një takim, aty kom shku për herë t'parë. Ka qenë viti 2000, besoj 2000 ka qenë. Vera ose pranvera e 2000-shit kur kom shku për herë t'parë në këtë takim.

**Aurela Kadriu:** Mandej ku i mbajshit takimet tjera? A keni pasë zyre, a keni pasë...

**Agon Maliqi:** Ka qenë ma s'pari qajo në, në Sallë të Kuqe. Mandej i kemi ndërru, me kujtesën teme, tri-katër zyre në ato dy vjet që kam qenë unë. Fillimisht kemi qenë në Breg të Diellit te ambullanta e qytetit. Përballë ambullantës ni banesë, kemi qenë ni verë aty. E kemi pasë ni, ni banesë që e kemi përdorë si zyre. Edhe mandej kemi qenë, për pjesën kryesore që mbaj mend une aktivitetet, kemi qenë në Dardani, te "Santea" që quhet ajo pjesa aty. Te banesa në Dardani ajo e verdha. Aty në kat të dytë e kemi pasë një banesë, që ka qenë e mobilume, e kemi domethonë pasë një zyrë të punës, kompjutera, salloni ka qenë si pjesë e takimeve, ku jemi mbledhë çdo ditë. Ata e mbaj mend si periudhë pak ma të gjatë, ka qenë dikun prej gjatë, krejt 2001-shit noshta deri n'fund të, deri ka gjysma e 2002-tës kemi qenë aty.

**Aurela Kadriu:** Po më intereson me ditë, tash ju jeni ashtu qajo që konsiderohet gjenerata e dytë e “Postpesimistave”? A ka pasë përbamje të “Postpesimistëve” pas luftës, si me thonë udhëheqës, ose najnjo që ju ka këshillu prej ktyne t’para luftës? A ka vazhdu linja e mendimit dhe aktivitetit me qenë e ngjashme me ato para luftës? Qysh ka evolu? Nëse mundesh, nëse man n’mend, nëse mundesh me m’tregu?

**Agon Maliqi:** Nuk e di n’fakt, noshta unë në fillimet kur kom qenë aty, kanë qenë disa anëtarë që kanë qenë pjesë e tranzicionit, kanë qenë edhe ma herët. Po ata ndoshta fillun me u largu ka pak, ka pak, se ndryshoi konteksti, ndryshoi interesimi, ndryshoi rrethi shoqëror. Krejt ai grupi ma kryesor, m’doket mo s’ka pasë qenë aty kur kom ardhë une. Edhe noshta manej edhe tjerët fillun me u largu. Po thom lufta i ka shkund krejt senet në Kosvoë, edhe ndryshun prioritetet e njerëzve, ndryshun asi.... Kështu që, me sa e di une, kur kom shku une në fillim, kur kom fillu me qenë shumë më aktiv, grupi ka qenë komplet tjetër prej atij që ka qenë para luftës.

Domethënë kemi qenë një, edhe si grup i njerëzve kemi qenë... edhe si grup i njerëzve po edhe si lloj i aktiviteteve dhe organizimit, kemi qenë krejt tjetër. E vetmja noshta lidhje ka qenë organizata norvegjeze që ka qenë *Norwegian People’s Aid*<sup>3</sup> që ka qenë themeluse atëhere edhe ka qenë vazhduse e mbështetjes financiare kryesore. Edhe aty-këtu naj kontakt i vjetër me “Postpesimistat” e rajonit që i kanë pasë disa anëtarë tonë, po jo krejt pi neve. Domethonë se edhe ajo lidhja që ka qenë atëhere me zyrat e tjera sikur pak u shkëput edhe nuk është që kemi funksionu kështu si rrjet rajonal mo, po më shumë kemi qenë si organizatë lokale.

## Pjesa e Dytë

**Aurela Kadriu:** A na bon njifarë renditje, domethonë qysh e mbanë mend ti t’aktiviteteve, t’llojit t’aktiviteteve edhe rolin tënd taman konkretisht tek “Postpesimistët”? Çka ke bo te “Postpesimistët”?

**Agon Maliqi:** Aktivitetet nuk i maj mend. Tash nuk osht’, nuk m’kujtohet saktë struktura, nuk osht’... s’e di a kemi pasë naj strukturë kështu koherente të programit të mirëmendume. Jemi marrë pak a shumë me gjithçka që na ka shku në mend. Po ka qenë domethonë ai... unë çka maj mend për veten teme kryesisht, si njeri pak ma shumë i anës mediave, unë jam marrë shumë me gazetën që e kemi prodhu. Kom qenë një kohë të gjatë edhe kryeredaktori i saj. Mirëpo kom qenë edhe nja dy mandate nëse s’gaboj edhe kryetar i “Postpesimistave”, dikun në vitin 2001 nëse s’gaboj, kemi pasë mandate gjashtëmujore a diçka e tillë. Edhe jom marrë me krejt kordinimin e krejt aktiviteteve.

Kështu që përveç gazetës jemi marrë me projekte vetëdijesuese për rininë domethënë me *AIDS*

<sup>3</sup> Ndhma e Popullit Norvegjez.

*awareness*, kështu vetëdijesimin për ashtu. Kemi pasë pak diçka projekte edhe me, domethonë për problemin e bashkëjetesës ndëretnike. Kemi prodhu një emision në radio, kemi bo aty-këtu aktivitete humanitare, nëse s'gaboj diçka, po s'po m'kujtohet diçka specifike. Domethonë, gjithçka ka pak njëfarë forme, po kryesisht... organizatë tipike rinore, a din që merret me këto shqetësimet e rinisë. Aty filloi pak edhe vetëdija edhe për drogën ta zojmë, se fillun me u shfaq edhe k'to problemet, a din. Fushata vetëdijësuse për efektet e drogës e gjona të tilla. Po për neve ndoshta pjesa ma e rëndësishme nuk kanë qenë edhe ashtu projektet sa kanë qenë efekti socializus që rrishim me një zyre, u knaqshim. Ma shumë ka qenë ajo, noshta edhe kënaqësia që na ka bo bashkë sesa angazhimi edhe projektet.

**Aurela Kadriu:** Çfare ka qenë natyra e shkrimeve që i bojshit në gazetë kryesisht?

**Agon Maliqi:** Natyra e shkrimeve i ka reflektu ato shqetësime tona që i kemi pasë. Ka qenë njëfarë periudhe e eksplorimit të kësaj lirisë që na erdh para syve, papritur, njëfarë lloj shpërthim i entuziazmit. Edhe njëfarë dëshire me i thy në tabu, me thy kufij që për neve kanë qenë noshta, domethënë që gjithçka ishte shumë e re. Përveç që ne ishim të rij edhe bota që na erdh neve ishte komplet e re edhe për Kosovën, kështu që kishim një lloj entuziazmi me u marr me, qoftë pak me gjana pak ma satirike me thy tabu, qoftë... po edhe me tema politike. Domethënë jemi marrë pak edhe me tema sociale, politike, me lirinë e shprehjes, e maj n'mend disa edicione e kemi trajtu edhe kët' temë. Jemi marrë me, çka tjetër, po me skenën alternative-kulturore, me bendet, gjona që na kan preukupu domethënë, muzika, tema kryesisht të tilla.

**Aurela Kadriu:** A keni organizu mbramje kulturore, ose qesi eventesh?

**Agon Maliqi:** Po ka pasë, ka pasë mbramje. E maj n'men kemi pasë pru një DJ... fushata jonë kundër drogës kemi pas pru një DJ t'njoftun atëhere, s'po m'kujtohet tash emri, që ka qenë DJ anglez. Sa pat fillu, fillimi i kësaj skenës elektronike të Prishtinës. Na patëm qenë organizator te kjo, Kino Rinia tash që osht' këtu, këtu përballë... ka qenë ni natë aty. Manej ka pasë edhe disa koncerte që i patëm bo. Njo ka pasë qenë për lirimin e Albin Kurtit. S'm'kujtohet shumë saktë kur ka qenë viti po e di që ka qenë edhe ajo te Santeja, te ai korridori në mes lokaleve. Jemi marrë me, me, me edhe me aktiv, goxha shumë me kët' pjesën e koncerteve.

**Aurela Kadriu:** Unë kam dëgju që juve që keni qenë pjesë e "Postpesimistave" ju ka ra me udhëtu shumë në kuadër të "Postpesimistave", që ka qenë, për kohën nuk ka qenë shumë e zakonshme. A po na tregon pak për qët' pjesë, për juve peronalisht qysh ka qenë?

**Agon Maliqi:** Po për mu personalisht, domethonë unë s'kom, mu nuk m'pat ra shumë me udhëtu derisa m'pat ra udhëtimi ma i rëndësishëm. Se na si organizatë rinore vazhdimisht vijshin ftesa

domethonë prej organizimeve të ndryshme nëpër botë edhe shumicës i bibe me shku nëpër konferenca, nëpër, nëpër. Mu m'pat ra me shku në New York në vitin 2000, u bëjshin përgatitjet për Konventën për të Drejtat e Fëmijëve. Edhe si përfaqësues i një organizatës të fëmijëve dhe të rijve të Kosovës, domethonë atëherë në moshën 16 vjet, 15-16 vjet, s'm'kujtohet saktë se ashtu, pata shku në New York si përfaqësues i organizatave rinore të Kosovës. Dy here, në dy seanca përgatitore në Kombet e Bashkume. Kjo ka qenë besoj në vitin 2000 edhe 2001. Kom qenë edhe niher në Gjenevë me një konferencë të ngjajshme, të ndërlihdun me këtë aktivitet, po domethënë për herë të parë e kom pa New York-un edhe Amerikën, me ndihmën e UNICEF-it<sup>4</sup> atëhere.

Kosova ka qenë njëfarë, atëhere ka qenë shumë temë interesante botnisht. Sa u pat përfundu lufta, kudo që shkojshe si i ri i Kosovës përmenshe Kosovën, krejt e dishin ku është, pak dallim prej tash, kemi dal pak prej hartës së ktyne vendeve që njihen. Edhe e kishim njëfarë lloj rrëfimi interesant prandaj edhe besoj kanë pasë ardhë shumë ftesa, jo vec për neve si t'ri po edhe për krejt, për kon'do prej Kosovës. Edhe kjo m'kujtohet, New York-u m'kujtohet.

**Aurela Kadriu:** A e mban mend çka ka qenë qasja jote në... a ke folë në konferencat që ke shku? Për çka ke folë?

**Agon Maliqi:** Nuk maj mend shumë mirë, po ka qenë ni tryezë tematike për, nëse s'gaboj, për fëmijët dhe konfliktet, diçka e tillë. E maj mend që dikun, meqë ishim si zonë post-konfliktuale, na ka pasë ftu edhe dikush prej Kosovës me folë aty. E di që në njonën prej atyne sallave të ndërtesës të OKB<sup>5</sup>-së në New York, e maj mend që kom qenë në panel edhe pata fol diçka, po me t'thonë t'drejtën nuk është që e maj mend çka konkretisht. Edhe kështu, po....

**Aurela Kadriu:** Në Prishtinë, ku ju keni vepru, qysh ka qenë mendimi për "Postpesimistat" si diçka që o kon e re, qysh ka qenë ajo qasja e njerëzve? Ma s'pari në familjen tënde për krejt qito udhëtime, aktivitete që i ke bo si i ri? Qysh e kanë pritë, a kanë ditë njerëzit për juve? A keni pasë naj mbështetje prej intelektualëve t'asaj kohe? Prej çka po di, qito sene...

**Agon Maliqi:** Mbështetje, prej familjes pa dyshim kom pasë mbështetje, bile edhe inkurajim për me qenë pjesë. Prej rretheve domethënë të tjera, po mundohem tash me, me kujtu, kanë qenë ndoshta, njerëzit e kanë njoftë organizatën. Domethënë e kemi pasë njëfarë lloj njohje si organizatë, kryesisht për shkak të punës së brezit t'maparshëm, se ata kanë qenë e vetmja organizatë rinore në njëfarë kohe. Edhe kudo që ke shku, për shembull tu ka dashtë për diçka, "Koha Ditore" për shembull për naj njoftim ose për diçka, njerëzit e kanë ditë kush janë "Postpesimistat", se shumica e anëtarëve mandej

<sup>4</sup> Fondi i Emergjencës i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët

<sup>5</sup> Organizata e Kombeve të Bashkuara.

kanë qenë gazetarë, në “Kohë Ditore” edhe ka pasë dalë fjala. Domethënë nuk e kemi pasë problem me i mobilizu mediat për naj aktivitet, me i ftu me ardhë, domethënë na kanë njoftë si organizatë.

Perceptimi, mandej, nuk e di ndoshta, kritikak shpesh nuk mbrijnë te ti, s’po di qysh me thonë. Kur je nji grup i mbyllun i njerëzve edhe rrin me ta nuk është që tash e dëgjon shumë dikush tjetër që t’shanë. Është e mundun që ka pasë najfarë lloj kështu perceptimi si diçka pak ma, a din, nji grup i njerëzve i mbyllun, që janë a din, ja majnë vetes si diçka, që s’është e hapun për t’tjerët. Po që unë nuk m’kujtohet si e tillë, se kemi qenë shumë t’hapun n’fakt për anëtarsi, nuk është që ka pasë aty naj kriter përjashtus ose ashtu. Kushdo që ka dasht me u angazhu ka mujtë, po zakonisht njerëzit pak hezitojnë nëse nuk e njohin dikën. Ne kemi qenë si grupe t’vogla shoqnore, a din, edhe shokët tanë kanë shku, kanë... edhe une kom shku për shembull se kanë qenë shokët e mi aty edhe mandej kështu njifarë forme jonë krijë...

**Aurela Kadriu:** Zinxhiri.

**Agon Maliqi:** Zinxhiri. Nuk është që ka qenë organizatë përjashtuse ose që ja ka marrë menja vetes. Në atë kohë kanë pasë fillu me dalë organizata t’tjera rinore se mundsitë kanë qenë, domethënë ka qenë ai shpërthimi i donacioneve, organizata ndërkombëtare që erdhën këtu. Domethënë ndrroi komplet vendi në njifarë forme. Po perceptimin e jashtëm nuk e di, ndoshta ma mirë është me fol dikush që s’ka qenë se qysh jena pa prej jashtë sesa unë që kom qenë pjesë e organizatës.

**Aurela Kadriu:** E mban mend përmbjlljen e aktivitetit tënd në “Postpesimista”? Qysh ka ndodhë qajo periudha e tranzicionit kur ti e ki lonë, nuk je marrë mo me to?

**Agon Maliqi:** Unë sa kom qenë aty, kom qenë shumë i zellshëm me punë, domethënë kom punu shumë, se e kom pas përnime njifarë interesimi, njifarë vullneti me prodhu gazetën, me punu dokumentar, m’u marrë me kështu me sende. Edhe njifarë forme tërheqja ka qenë siç ndodhë n’atë moshë domethënë je i interesum për diçka nji periudhë, e ngon nji lloj muzike edhe mandej e len. Ka qenë nji cikël i natyrshëm ku t’kalon ajo faza e interesimit për diçka edhe fillon pak me u tërhekë. Unë nuk e maj mend, nuk e mbaj mend saktë pse dhe qysh, po thjeshtë fillova me u marrë me ndoshta, me gjana t’tjera.

M’kapi njifarë lloj interesimi mu marr me regji, atëherë dojsa me studiu regji, prodhojsa video, merrsha kamera, eksperimentojsa, ma shumë u mbylla mbrenda vetes edhe punojsa ksi projekte t’miat eksperimentale n’shpi edhe e lashë pak angazhimin n’organizatë. Mandej shkova për studime jashtë edhe e hupa atë, aty u hupa komplet manej. Manej faktikisht, prej masi jom largu prej Kosovës, atëhere në qat’ periudhë dikur edhe mo nuk, organizata si e tillë u shu n’njifarë forme, s’kish mo

njerëz aty. Nuk pat naj gjeneratë tjetër që erdh mbas neve me vazhdu atë trendin.

**Aurela Kadriu:** A po na flet për periudhën e studimeve, qysh keni shku për studime edhe ku keni studiu?

**Agon Maliqi:** Unë kom shku në Universitetin Amerikan në Bullgari, që është në Blagoevgrad, nja katër-pesë orë prej Prishtinës. Ka qenë ni thirrje për aplikim që bohej zakonisht përmes zyrës së Sorosit këtu në Prishtinë. Ata e administrojshin atë aplikimin. Edhe kom pasë ndëgju shumë për Universitetin prej njerëzve që kishin qenë ma herët. Me insistimin e prindëve kom apliku, për shkak se unë siç thashë, unë kom dashtë me shku në regji, këtu në Prishtinë. Edhe ma shumë kom shku me apliku për m'i ja bo qejfin atyne se sa që kom dashtë vet.

Edhe e maj n'men pata shku me i bo ato testet TOEFL-in edhe SAT-in që u administrojshin këtej në Prishtinë. Edhe u pata pranë manej. E manej, prap me shumë hezitim, po njifarë forme, nashta ma shumë me insistimin e prindëve vendosa me shku atje.

**Aurela Kadriu:** Çka ke studiu atje edhe për qat' periudhë a po na tregon qysh ka qenë për ty?

**Agon Maliqi:** Shkenca politike edhe studime evropiane, kështu *double major* [lëndë kryesore të dyfishta] që i thojnë dy, dy... po t'ndërlidhuna i kanë pasë shumë lëndë. Periudhë, po menoj, osht' noshta periudha ma e randësishme për mu, n'jetën teme domethonë. Edhe i kom falenderu shumë prindët une. Qysh në javën e dytë kur kom shku atje ju kom thonë "Faleminderit që m'shtinët me ardhë këtu, që m'nxirrët pak prej Prishtinës". Osht', ka qenë një botë krejt tjetër për shkak se dikun rreth njëmijë studenta prej krejt Evropës Lindore. Shumë vende të ndryshme.

As nuk u nijshe shumë larg prej shpisë se ishe, ishim afër. Po edhe kishim shumë të Kosovës e të Shqipërisë. Shumë shqiptarë kemi qenë në komunitet. Nuk u nijshe shumë as i huji as... po edhe kishte at' diversitetin, mujshe me taku njerëz të ndryshëm. Po ma revolucionare prej krejtve ka qenë sistemi i arsimit. Domethonë ajo ideja që kur shkon me ni klasë edhe diskuton në njifarë forme për, profesori t'vet ty, "Ça menon ti?" Që për mu ish kështu {bën si i habitur}, domethonë... atë klasën e parë kur erdh profesori edhe m'pyti, "Ça menon ti?"

S'jemi mësu na me atë lloj pedagogjie. Ka qenë shumë shliruse ajo ideja që munesh me marrë pjesë, munesh me shkrujt edhe mendimi jot' vlen. Ka qenë shumë domethonë, katër vjet ku kom mësu shumë po edhe jom rritë individualisht shumë për shkak t'njerëzve, për shkak të domethonë edhe jetës sociale që ka qenë atje.

**Aurela Kadriu:** Edhe mbas studimeve mandej çka keni bo?

**Agon Maliqi:** Kthim në Prishtinë, ku kom punu për nja një vit projekte të ndryshme. Kështu ma shumë ad-hoc deri sa kom nis me punu për “Nismën e të Rinjëve për të Drejtat e Njeriut”. Edhe aty me njëfarë lloj, ta qujmë, vazhdimësie të “Postpesimistave” nuk e kisha thanë po frymë e ngajshme e punës. Se edhe “Nisma” ka qenë njëfarë lloj rrjeti rajonal që osht’ marrë me, edhe pak edhe këtë pjesën e *transitional justice* [drejtësisë tranzicionale] të, domethonë të drejtësisë tranzicionale. Po, edhe me zhvillimin e mendimit kritik me t’ritë. Domethonë aty pak, nja 1 vit kom punu aty.

Edhe mandej njëfarë forme kjo pjesa e punës, angazhimit, aktivizmit pak fillon bjen edhe kom fillu me ju futë n’kët’ industrinë e zhvillimit që quhet, donatorëve e projekteve zhvillimore. T’u punu për Ambasadën Norvegjeze ma s’pari, e mandej t’u vazhdu me.... Domethonë kom shku prapë në Amerikë për magjistraturë në vitin 2010.

**Aurela Kadriu:** Çfarë dege ke qenë?

**Agon Maliqi:** Politikat zhvillimore. Këto, këto, domethonë pak filloj m’u zhvillu profesionalisht ma shumë në qet’ fushën e politikave publike edhe politikave zhvillimore. Kom qenë dy vjet në Amerikë. Edhe kur jom kthy e kom vazhdu prapë qat’ fushë. Domethonë kom punu për UNDP-në<sup>6</sup>, mandej prej atëhere si konsulent kryesisht për shumicën e këtyne donatorëve që jonë këtu, në Kosovë. Studime, analiza, raporte. Po gjithmonë t’u mos e harru qat’far angazhimin... domethonë osht’ njëfarë filli, njëfarë vazhdimësie prej “Postpesimistave”, s’po di qysh me thonë, që vazhdon edhe që e ndej t’u m’ndjekë.

Domethonë qoftë me “Nismën e të Rinjëve për të Drejtat e Njeriut” mandej edhe me... tash nashta edhe me “Sbunker-in” njëfarë lloj filli i angazhimit, fryme ideologjike e përafërt, e kisha qujtë, po që domethonë m’shpërthen mu kështu kohë pas kohe si njëfarë lloj platforme tjetër. Jo pse, domethonë jeta po të ndahet tash në ato profesionale, ku punon në njëfarë forme pak edhe për jetesë edhe për kështu, edhe këto tjerat që jonë pak si t’qejfit, që jonë si pjesë të aktivizmit ma shumë se sa si kështu të, a din, veç thjeshtë punë.

**Aurela Kadriu:** Tash aktualisht me çka, me çka mirreni? Qysh osht’ jeta juj n’qatë *tube* [linjë] me na tregu nëse mundesh?

**Agon Maliqi:** Tash jom, domethonë vazhdoj me punu kështu si konsulent i politikave publike, që osht’ ajo që ma siguron jetesën. Punoj për... osht’ shumë ma, osht’ ma si *freelance* [i pavarur] si angazhim

<sup>6</sup> Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim.

domethonë, kom projekte kohë pas kohë që ma mundësojnë, që ma mundësojnë me, me bo atë jetën t'cilën du me bo. Edhe kom "Sbunker-in" që e kom si projekt, si nismë që e kemi nisë bashkë me ni koleg para dy vjetësh, që osht' ma shumë si *passion project* [punë pasioni]. Edhe me këto dyja faktikisht merrem.

Edhe jeta jeme qysh doket? Osht' ni jetë n'levizje vazhdimisht se jetoj n'mes Prishtinës edhe Tiranës ka që tri-katër. Domethonë jom prej atyne, nashta nuk jemi shumë ky komuniteti jonë që e bojmë këtë jetë, domethonë që na ka mundësu rruga e kombit më lëvizë prej knej ose anej. Kështu që osht' ni fazë e re njifarë forme mes dy qyteteve t'u jetu. Udhëtoj gati çdo javë edhe po arrij me i përjetu dy qytete, paralelisht me i jetu. Po. Kështu që kjo osht'.

**Aurela Kadriu:** Nëse nuk ki diçka me shtu, unë e kisha përmbyllë qitu intervistën.

**Agon Maliqi:** Okej.

**Aurela Kadriu:** Faleminderit shumë.

**Agon Maliqi:** Faleminderit.